



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Tiranë, më 16.06.2008

Njoftim për shtyp

**Mbi çështjen gjyqësore mes Autoritetit të Konkurrencës dhe tetë kompanive të sigurimit**

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin e datës 16.06.2008, rrëzoi kërkesë-padinë e ngritur nga 8 shoqëritë e sigurimit duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr 50, datë 21.03.2007 "Për vendosje gjobe ndaj shoqërive që veprojnë në tregun e sigurimit të detyrueshëm, për produktin Policë Kufitare".

Në vendimin nr 50 të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në ligjin nr 9121 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" u vendos ndalimi i aktmarrëveshjes "Mbi themelimin e Pool-it të Sigurimit Kufitar të Përgjegjësive ndaj palëve të treta të mbajtësit të mjetit motorrik", e lidhur nga 8 shoqëri siguri: Sigma, Sigal, Atlantik, Intersig, Interalbani, Albsig, Eurosig dhe Insig, si një marrëveshje e ndaluar me pasoja kufizuese për konkurrencën pasi fiksonte çmimin dhe ndante tregun.

Komisioni me këtë vendim ka gjobitur në masën 2 % të xhiros së vitit 2005 të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe në bazë të nenit 80 të ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" është Policia Tatimore organi i ngarkuar me vjeljen e këtyre gjobave.